




Pranuar / Dorëzuar Prenheno/Prodato Received/Delivered	03.12.2021	viti god year	
Organ /Njesia Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5793/2021		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.890/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.890/2021 të datës 28.10.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Fshati "Balinc", Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.890/2021 i datës 28.10.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 28.10.2021 me numër të protokollit 5200/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 04.10.2021 me numër 01/894 i Komisionit për Vlerësim.

Ankusi me datë 30.11.2021 me numër të protokollit 5701/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka paraqitur kërkesën për tërheqje të ankesës me numër A.nr.890/2021 të datës 28.10.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës. Komuna e Malishevës me datë 11.11.2021 kthen përgjigje në ankesën e ankuesit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/52.

Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 28.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi idatës 15.07.2021;Vendimi i datës 04.10.2021 me numër 01/894 i Komisionit për Vlerësim; Njoftimi me numër 01/671 i datës 19.08.2021 nga Udhëheqësi i Personelit; Vendimi m enumër 01/790 i datës 01.09.2021 për formimin

e Komisionit për Vlerësim; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi i datës 27.09.2021 për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve me fitues për pozitën zyrtar i personelit; Ankesa e ankuesit e datës 28.09.2021 e parashtruar në Komunën e Malishevës; Përgaditja profesionale, përvoja e punës dhe çertifikatat e trajnimeve për kandidatin Përgaditja profesionale, përvoja e punës dhe çertifikatat e trajnimeve për kandidatin Përgjigjia në ankesë e organit të punësismit e datës 11.11.2021 shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe Kërkesa e ankuesit e datës 30.11.2021 për tërheqje të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.890/2021 të datës 28.10.2021 e parashtruar nga ankuesi sepe:

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, ka konstatuar se ankuesi me datë 28.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5200/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 30.11.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 5701/2021 për tërheqje të ankesës me numër A.nr.890/2021 e me numër të protokollit 5200/2021 të datës 28.10.2021 për arsye personale. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.890/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

